

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE 2024

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	08.10.2024	Tiranë, 08.10.2024 Kërkesë drejtuar QKK, Kryetarit Z. Eol Çashku Unë, E***** B*****, me cilësinë e kërkuesit, në emër personal, si skenarist dhe regjisor i projektit filmik “Muza e ëndrrave të vrara”, paraqitur për konkurim më dt 06 shtator 2024, i bazuar në të drejtën që më njeh Kushtetuta, si shtetas i këtij vendi dhe bazuar në Ligjin 119/2014 "Për të drejtën e informimit" si palë e interesuar, i kërkoj QKK, të më informojë me hollësi për mënyren se si kanë votuar anëtarët e Komisionit të Miratimit të Projekteve, numurin e pikëve të secilit anëtar, emër dhe mbiemër. Po ashtu kërkoj të më vihen në dispozicion të gjitha filmimet e kryera prej jush, si diskutimet e Komisionit të Miratimit të Projekteve për gjithsecilin konkurues dhe paraqitjen e projekteve prej konkurrentëve të tjerë më dt 03 tetor 2024. E***** B*****	08.10.2024	Lënda: Mbi kërkesën tuaj për vënien në dispozicion të fletëve të votimit dhe filmimet audio - video të mbledhjes së KMP. Z. E***** B***** KINEAST I nderuar Zoti B*****, Uroj të jeni mirë. Në përgjigje të kërkesës suaj për informim, ju bëj me dije se jeni i mirëpritur në Qendrën Kombëtare të Kinematografisë për të konsultuar fletët e votimit me argumentimin me shkrim dhe pikët por edhe proceverbalin audio - video të mbledhjes së Këshillit Miratues të Projekteve për Filmin Artistik me Metrazh të Gjatë. Për arsye të riorganizimit administrativ të QKK, vizita juaj duhet të jetë pas datës 16 Tetor 2024. Sa më lart, lutem na njoftoni paraprakisht për vizitën tuaj pas kësaj date. Ju falenderoj paraprakisht për mirëkuptimin, Sinqerisht, KRYETARI Eol Çashku	E plotë	Nuk ka

2	16.10.2024	Tiranë 16.10.2024 Përgjigje letrës suaj të dt 8-10-2024 Duke ju falenderuar për gatishmërinë dhe mirëkuptimin, ju bëj me dije se do të jem prezent në QKK në dt. 18 tetor rreth orës 11. 30 , ku do më duhet të marr me vete kopje të fletëvotimeve me shkrim, pikëve dhe një kopje të procesverbalit audio- video të mbledhjes së Këshillit Miratues të projekteve, për ta konsultuar me specialistë në një moment të dytë. Me respekt Edmond Budina	18.10.2024	Lënda: Lidhur me kërkesën për informacion. Z. E***** B***** I nderuar Zoti B*****, Në vijim të korrespondencës lidhur me kërkesën tuaj për informim mbi materialet e mbledhjes së Këshillit të Miratimit të Projekteve (KMP) të datës 3.10.2024, si dhe materialin audio-video, Ju bëj me dije se: Në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", jeni i mirëpritur të konsultoni materialet e mbledhjes së Këshillit të Miratimit të Projekteve të datës 3.10.2024, të cilat i takojnë projektit të paraqitur nga shtëpia kinematografike "AB FILM" SHPK, si dhe vendimmarrjes së KMP lidhur me këtë projekt. Në këtë proces mund të merrni pjese personalisht, ose edhe i shoqëruar nga persona të tjerë, ekspertë, përfaqësues ligjor, etj. Vlerësimi i KMP për projektin "MUZA E ËNDRRAVE TË VRARA", skenari dhe regjia E***** B***** , ka qenë si më poshtë: Seksioni i vlerësimit për skenarin Anëtari 1 : 16 Anëtari 2 : 15 Anëtari 3 : 15 Anëtari 4 : 10 Anëtari 5 : 14 Totali : 70 Seksioni i vlerësimit për regjisorin Anëtari 1 : 16 Anëtari 2 : 16 Anëtari 3 : 15 Anëtari 4 : 15 Anëtari 5 : 14 Totali : 76 Seksioni i vlerësimit për produksionin Anëtari 1 : 8 Anëtari 2 : 7	E plotë	Nuk ka
---	------------	---	------------	--	---------	--------

			Anëtari 3 : 5 Anëtari 4 : 10 Anëtari 5 : 8 Totali : 38 Totali për çdo vlerësim Anëtari 1 : 40 Anëtari 2 : 38 Anëtari 3 : 35 Anëtari 4 : 35 Anëtari 5 : 36 Totali : 184 Për arsye të ruajtjes së autonomisë dhe integritetit profesional të vendimmarrjes së KMP fletët e votimit mund t'i merrni fotokopje, por pa u evidentuar emrat e anëtarëve të KMP. Lidhur me kërkesën tuaj për vënie në dispozicion të materialit audio-video të mbledhjes së KMP, Ju vëmë në dijeni se mund ta konsultoni vetëm në ambientet e QKK, pasi të nënshkruani Deklaratën e Konfidencialitetit. Kopje të materialit nuk mund të merrni, pasi anëtarët e KMP të pranishëm në mbledhje nuk e kane autorizuar QKK për përdorim të imazhit të tyre në zbatim të nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe pikës 116 të Udhëzuesit të Këshillit të Evropës (CoE) për zbatimin e këtij neni. Ju falenderoj për mirkuptimin, KRYETARI Eol ÇASHKU		
--	--	--	---	--	--

3	27.11.2024	I nderuar Z. Çashku, Bashkëngjitur do të gjeni një kërkesë zyrtare nga Shoqata AWA në lidhje me vendimet e KMP-së të datave 25.10.2024 dhe 20.11.2024 për kategorinë Koproduksion në Pakicë. Kërkesa jonë fokusohet në dy aspekte kryesore: • Arsyetimin e thirrjes së dytë të KMP-së për të njëjtin qëllim • Bazën ligjore të përdorur për rishqyrtimin e vendimit Duke pasur parasysh rëndësinë e këtyre vendimeve për zhvillimin e kinematografisë shqiptare dhe projektet tona në pritje, do të vlerësonim një përgjigje sa më të shpejtë nga ana juaj. Me respekt ----- S***** K***** Executive Director	02.12.2024	E nderuara, Znj. K*****! Në përgjigje të kërkesës suaj, në lidhje me vendimet e KMP-së, të datave 25.10.2024 dhe 20.11. 2024 për kategorinë Koproduksion në Pakicë, ju vëmë në dijeni se: 1. Vendimi i KMP-së u rishikua në bazë të nenit 144 të KPA-së mbi Rishikimin dhe 2. Në bazë të mundësisë së rezervës financiare që u krijua në këtë moment. Në këto kushte, u mor edhe vendimi i KMP-së i cili ishte konsequent me sa u përmend më lart. Duke shpresuar që përgjigja e administratës së QKK-t'ju ketë shërbyer në veprimtarinë tuaj, ju uroj punë të mbarë!	E plotë	Nuk ka
---	------------	--	------------	--	---------	--------

4	26.12.2024 27.12.2024	Tirane me 26.12.2024 Drejtuar: Z. Eol ÇASHKU Kryetar i Qendrës Kombëtare të Kinematografisë Zoti Kryetar, Ne vendimin e Keshillit të miratimit të projekteve nr. s'ka, date 26/12/2024 konstatoj se projekti im për film të metrazhit të shkurtër Dite shiu, skenari B**** H****, regjia S**** H****, E** G****, nuk është renditur tek projektet fituese. Mbi bazën e nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë: 1. E drejta e informimit është e garantuar. 2. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore. 3. Kujtdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive. si dhe nenit 3 e vijues të ligjit nr. 119/2014 PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT kërkoj të njihem me: - Fletet e votimit të secilit anëtar të bordit për projektin tim Dite shiu - Fletet e votimit për të gjithë projektet konkurruese - Regjistrimin audio të mbledhjes	07.01.2025	I nderuar Z. V****, Pranë Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, në datat 26 dhe 27 dhjetor 2024, respektivisht me numrat 512 dhe 512/1 të protokollit të QKK-së, ju keni paraqitur nëpërmjet postës dhe e-mail-it një kërkesë, ku kërkonte: (i) Fletët e votimit të secilit antar të bordit për projektin “Ditë shiu”, (ii) Fletët e votimit për të gjithë projektet konkurruese, (iii) Regjistrimin audio/video të mbledhjes së KMP-së, (iv) Procesverbalin ose regjistrimin audio/video të zgjedhjes së anëtarëve të KPL-së. (v) Procesverbalin ose regjistrimin audio/video të mbledhjes së KPL-së. 1. Në lidhje me fletët e votimit, të secilit antar të Këshillit Miratues të Projekteve të Filmit Artistik, ku është vlerësuar me pikë projekti i juaj “Ditë shiu”, një faksimile të tyre e gjeni të bashkëlidhur kësaj shkrese. Shënojmë se, këtyre faksimileve u janë fshirë emrat dhe nënshkrimet e anëtarëve të Këshillit Miratues të Projekteve. Arsyeja për këtë ka të bëjë me faktin se, fjalia e III-të e nenit 8, të ligjit nr. N.8096, datë 21.03.1996, “Për Kinematografinë”, të ndryshuar, sanksionon se: “Këshillat miratues të projekteve janë organizma të përkohshëm dhe jofunksionalë.” Duke qenë se KMP-ja cilësohet si një organizëm jofunksionar, atëherë edhe antarët e saj janë jo funksionarë. Pra, ata nuk gëzojnë statusin e funksionarëve publikë. Rrjedhimisht, këta të	E pjesshme	Nuk ka
---	--------------------------	---	------------	---	------------	--------

	Gjithashtu, ne kerkojme qe ne baze te te njejtit ligj mbi transparencën 1. Te disponojme procesverbalin si u zgjodh KPL (procesverbal ose materiali audio/video) 2. Gjithe materialin respektiv te mbledhjes ku kualifikuan scriptet per ne pjesen finale te gjykimit nga KMP.(procesverbal ose material audio/video). Ne ne baze te ligjit keni 10 dite kohe per te na vene kete material ne dispozicion. Me respekt S***** V***** Tirane me 27.12.2024 Drejtuar: Z. Eol ÇASHKU Kryetar i Qendrës Kombëtare të Kinematografisë Zoti Kryetar, Ne vijim te kerkeses tone te dorezuar ditën e djeshme date 26.12.2024, Ju bejme me dije qe sistemin audio/video qofte per KPL ashtu dhe per KMP e kerkoj pa asnje lloj shkurtimi dhe natyrisht do te marrim eksperte te licensuar dhe te njohur nga gjykata qe vertetojne integritetin total te materialit. Pra, qe materiali eshte pa prerje apo cungime te asnje lloji.	fundit gëzojnë plotësisht “të drejtën për një jetë private”, të garantuar nga Neni 8-1 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe Lirive Themelore, sipas interpretimit që i është bërë asaj prej Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në këtë kuadër, Qendra Kombëtare e Kinematografisë është e detyruar që të mbrojë integritetin dhe reputacionin vetjak e profesional të të gjithë antarëve të KMP-së, sikundër është vendosur prej GJEDNJ-së, në çështjet: Aksel Springer AG k. Germany [Dh.M.], 2012, Shovi e të tjerë k. Francës, 2004, Paifer k. Austrisë, 2007; Petrina k. Rumanisë, 2008; Polanko Torres dhe Movila Polanko k. Spanjës, 2010, Putistin k. Ukrainës, 2013, si dhe Denisov k. Ukrainës [Dh.M.], 2018. 2. Në lidhje me fletët e votimit, të secilit antar të Këshillit Miratues të Projekteve të Filmit Artistik, ku janë vlerësuar me pikë të gjitha projektet e tjera, që janë shqyrtuar më datë 24 dhjetor 2024, ju sqarojmë se: (a) Shqyrtimi i projekteve dhe vlerësimi i tyre me pikë përbën përpunim të të dhënave vetjake (personale), si dhe të të dhënave që mbrohen nga e drejta e autorit, prej Këshillit Miratues të Projekteve, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga subjektet aplikuese, me vullnetin e tyre të lirë, në përputhje me kërkesat e “rregullores së përgjithshme të mbështetjes financiare dhe të lejeve”, të ndryshuar, e cila është miratuar nga Kryetari i QKK-së, dhe është protokolluar me numër 168, më datë 27 maj 2025.		
--	---	---	--	--

		Me respekt S***** V*****	(b) Dokumentacioni që paraqitet prej aplikantëve pranë QKK-së, për t'u shqyrtuar dhe vlerësuar nga Këshilli Miratues i Projekteve përmban qartësisht të dhëna vetjake (personale), të tilla si: diploma të regjisorëve, skenaristëve dhe producentëve, jetëshkrimin e tyre (CV), informacione e plane financiare, vlerësimi me çmime, pjesëmarrja ne festivale ndërkombëtare, etj. Gjithashtu, skenarët dhe materialet dhe materialet e plotësuese, të tilla si: videot e filmave të fundit që janë realizuar prej tyre, janë të regjistruara pranë Drejtorisë për të Drejtën e Autorit, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Pra, këto të fundit mbrohen nga “e drejta e autorit”. (c) Në këto kushte, në bazë e në përputhje ne Nenin 35-2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, që sanksionon se: “Mbledhja, përdorimi dhe bërja publike e të dhënave rreth personit bëhet me pëlqimin e tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj.”, dhe gërmën “b” të pikës 4, dhe pikës 2 të Nenit 5, të Konventës 108+ “për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave vetjake/personale” e Këshillit të Europës, që sanksionojnë se: “Çdo Palë do të garantojë që përpunimi i të dhënave mund të kryhet bazuar në pëlqimin e lirë, specifik, të informuar dhe të qartë të subjektit të të dhënave ose të ndonjë baze tjetër legjitime të përcaktuar me ligj. Të dhënat personale, që i nënshtrohen përpunimit, do të: ... mblidhen për qëllime të qarta, të specifikuara dhe të ligjshme dhe të mos përpunohen në një mënyrë të papajtueshme me ato qëllime ...”, Qendra Kombëtare e Kinematografisë NUK mund t'ju vendosë në dispozicion ASNJË		
--	--	-------------------------------------	--	--	--

			faksimile të fletëve të votimit, (të dhëna të përpunuara, në kuptim të ligjit) të projekteve të tjera, PA marrë më parë, shprehimisht, pëlqimin me shkrim të aplikantëve të tjerë, duke qenë se këto të dhëna NUK mund të përpunohen apo shpërndahen nga QKK-ja për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë mbledhur prej saj. (e) Shënojmë gjithashtu se materialet, si skenarë apo video të filmave të fundit, mbrohen nga (i) Konventa e Bernës “për mbrojtjen e veprave letrare dhe artistike” dhe (ii) ligji me nr.35/2016, «Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to», të ndryshuar. 3. Në lidhje me regjistrimin audio/video të mbledhjes së Këshillit Miratues të Projekteve të Filmit Artistik, më datë 24 dhjetor 2024, ju bëjmë me dije se: (a) Në këtë mbledhje kanë marrë pjesë antarët e Këshillit Miratues të Projekteve, disa nëpunës të administratës së QKK-së, të cilët, kanë qënë prezent për realizimin e detyrave të tyre funksionale, si dhe aplikantët (producentë, regjisorë, skenaristë, etj). Këta të fundit kanë paraqitur gojarisht projektet e tyre përpara antarëve të KMP-së, ku ndër të tjera, kanë përmendur edhe të dhëna apo informacione me karakter vetjak (personal), sipas përkufizimit të gërmës a, të nenit 2, të Konventës 108+. Gjithashtu, në këtë mbledhje janë trajtuar edhe materiale të mbrojtura nga e drejta e autorit, të tilla si skenari. Ndërkohë, përgjatë paraqitjes gojarisht të projekteve, antarët e KMP-së edhe i kanë shqyrtuar, ndër të tjera, edhe duke ju drejtuar pyetje		
--	--	--	---	--	--

				aplikantëve. Kjo përbën përpunim të të dhënave personale. (b) Në çështjen Von Hanover k. Gjermanisë (nr. 2), paragrafi 96, Dhoma e Madhe e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut është shprehur se: “Gjykata njih të drejtën e çdo personi për mbrojtjen e imazhit të vet, duke theksuar se imazhi i personit përbën një nga veçoritë kryesore të personalitetit të tij, sepse zbulon karakteristikat unike të personit dhe e dallon atë nga të tjerët. E drejta e mbrojtjes së imazhit personal është kështu një nga komponentët thelbësorë të zhvillimit personal dhe presupozon kryesisht të drejtën e individit që të kontrollojë përdorimin e imazhit të vet, përfshirë të drejtën për të refuzuar publikimin e tij.”. Dhënia e këtij materiali, në kuadër të së drejtës së informimit, nënkupton bërjen publik të tij, pra publikimin e tij, duke lejuar shfaqjen dhe përdorimin e imazheve të individëve, të cilët, kanë marrë pjesë në këtë mbledhje. Ndërkohë, QKK-ja NUK ka pasur për qëllim bërjen publike të këtij regjistrimi, në momentin e realizimit të tij. Gjithashtu, QKK-ja NUK i ka marrë autorizimin me shkrim individëve pjesëmarrës në këtë mbledhje, në mënyrë që t’a shpërndajë ligjërisht atë, në kuadër të së drejtës së informimit. (c) Në këto kushte, në bazë e në përputhje ne Nenin 35-2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, që sanksionon se: “Mbledhja, përdorimi dhe bërja publike e të dhënave rreth personit bëhet me pëlqimin e tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj.”, dhe gjurmën “b” të pikës 4, dhe pikës 2		
--	--	--	--	--	--	--

			të Nenit 5, të Konventës 108+ “për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave vetjake/personale” e Këshillit të Europës, që sanksionojnë se: “Çdo Palë do të garantojë që përpunimi i të dhënave mund të kryhet bazuar në pëlqimin e lirë, specifik, të informuar dhe të qartë të subjektit të të dhënave ose të ndonjë baze tjetër legjitime të përcaktuar me ligj. Të dhënat personale, që i nënshtrohen përpunimit, do të: ... mblidhen për qëllime të qarta, të specifikuara dhe të ligjshme dhe të mos përpunohen në një mënyrë të papajtueshme me ato qëllime ...”, Nenit 8-1 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, sipas interpretimit të Dhomës së Madhe, në çështjen Von Hannover k. Gjermanisë (nr. 2), Qendra Kombëtare e Kinematografisë NUK mund t’ju vendosë në dispozicion ASNJË material audio-vizual të mbledhjes së KMP-së, më datë 24.12.2024, PA marrë më parë, shprehimisht, pëlqimin me shkrim të individëve përkatës të përfshirë, duke qenë se këto të dhëna NUK mund të përpunohen apo shpërndahen nga QKK-ja për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë mbledhur prej saj. 4. Në lidhje me procesverbalin ose regjistrimin audio/video të zgjedhjes së anëtarëve të KPL-së, si dhe procesverbalin ose regjistrimin audio/video të mbledhjes së KPL-së, ju bëjmë me dije se: (a) Në kërkesën tuaj ju NUK keni treguar se cilës mbledhje të KPL-së i referoheni. (b) Në qoftë se ju i referoheni mbledhjes së fundit të KPL-së, pra asaj të datës 20 dhjetor 2024, ku ju keni qenë konkurrent me		
--	--	--	---	--	--

			projektin tuaj, sikundër ju mund t’a keni mësuar tashmë rezultatin e saj nga njoftimi i bërë në faqen zyrtare të internetit të QKK-së, e cila, gjendet në këtë URL: https://qkk.al/index.php/2024/12/23/njoftim-lidhur-me-mbledhjen-e-kpl/. Shënojmë se, ajo mbledhje është konstatuar si absolutisht e pavlefshme proceduralisht nga Kryetari i QKK-së, nëpërmjet vendimit nr.19, të datës 20.12.2024, dhe me nr. 500/1 prot. (ky akt gjendet në URL e përmendur më lart). Pra, vendimmarrja e saj NUK ka prodhuar ASNJË pasojë, përfshirë edhe ju. Gjithashtu, të gjitha projektet e paraqitura për konkurrim pranë KPL-së, i kanë kaluar për shqyrtim drejtpërdrejtë mbledhjes së KMP-së, të datës 24.12.2024. Akti përkatës i këtij veprimi gjendet në URL-në e përmendur më sipër. (c) Rrjedhimisht, mbledhja KPL-së, e datës 20.12.2024, NUK ka sjellë ASNJË pasojë, aq më tepër negative, mbi projektin tuaj, dhe mbi asnjë projekt tjetër. (d) QKK NUK disponon informacionet e kërkuara prej jush lidhur me këtë mbledhje. Me respekt, KOORDINATOR PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT		
--	--	--	---	--	--